1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia / njesia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Koha e Pajtimit
1	Implementimi i Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse	1 / Set			
2	Implementimi I Modullit AI ne Aplikacionin Mobile OSHEE	1 / Set			
3	Integrimet me Sistemet Ekzistuese	5 / Sistem			
4	Server AI (Inteligjencës Artificiale)	2 / Cope			
5	Instalim, konfigurim i pajisjeve fizike	1 / Set			
6	Trajnim i përdoruesve	15 / Dite			
7	Mirëmbajtja e Platformës së Inteligjencës Artificiale software dhe hardware	24 / Muaj			
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Sipas termave të referencës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 8: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 15.	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
<i>(Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)</i>	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 16.	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 17.	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 19.	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Draft i Marrëveshjes Kuadër (Ku përcaktohen të gjitha kushtet)	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Shtojca 20	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
Draft Marrëveshja Kuadër	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
<i>(Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet)</i>	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.

Shtojca 25: Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, në përfundim të afateve të ankimimit Gabim! Shenja e referimit e pade

(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor).....**Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.**

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar**Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.**

Shtojca 25......**Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.**

FORMULARI I ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIMIT**Gabim! Shenja e referimit e**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.**

1. HYRJE

Operatori i Shpërndarjes së Sistemit Energjetik (OSHEE) është kompania kryesore përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë elektrike në Shqipëri. Si një institucion i rëndësishëm në sektorin energjetik, OSHEE shërben miliona klientë në të gjithë vendin dhe menaxhon një infrastrukturë komplekse të rrjetit të shpërndarjes së energjisë.

Gjatë viteve të fundit, OSHEE ka investuar në modernizimin e sistemeve të saj operacionale, duke implementuar sisteme të ndryshme elektronike për menaxhimin e klientëve, leximin e matësve, faturimin dhe menaxhimin e forcës punëtore. Megjithatë, këto sisteme funksionojnë kryesisht në mënyrë të izoluar dhe mbështeten në procese manuale që janë të ndjeshme ndaj gabimeve njerëzore.

Në kontekstin e transformimit digjital global dhe nevojës për rritjen e efikasitetit operacional, OSHEE ka identifikuar nevojën për implementimin e një platforme të integruar të Inteligjencës Artificiale që do të revolucionarizojë mënyrën se si kompania menaxhon operacionet e saj të përditshme.

1.1. Situata Aktuale në Sektor

Aktualisht, OSHEE operon me sisteme të ndryshme që përfshijnë:

- **Sistemi i Billing/CRM** për menaxhimin e klientëve dhe faturimin
- **Sistemi Mobiread** për leximin e matësve përmes fotografive
- **Sistemi GIS** për menaxhimin gjeografik të infrastrukturës
- **Sistemi i Work Force Management** për koordinimin e ekipeve
- **Sistemi AMI (Smart Meters)** për leximin automatik të matësve

1. **Sistemi Advanced Metering Infrastructure (AMI)** ka një rol thelbësor në transformimin e mënyrës se si menaxhohet dhe shpërndahet energjia elektrike. Ai përfshin një rrjet matësish inteligjentë, sisteme komunikimi dhe platforma të analizës së të dhënave që lejojnë mbledhjen dhe transmetimin automatik të informacionit mbi konsumimin e energjisë në kohë reale. Përmes AMI, është e mundur monitorimi i ngarkesës, zbulimi i ndërprerjeve ose humbjet e energjisë, si dhe përmirëson planifikimin dhe mirëmbajtjen e sistemit energjetik
2. **Network Energy Services (NES)** është një platformë inteligjente për menaxhimin e energjisë elektrike. Luan një rol të rëndësishëm në modernizimin e rrjetit elektrik përmes ofrimit të zgjidhjeve të avancuara të matjes inteligjente dhe menaxhimit të energjisë. Ky sistem lejon komunikimin në kohë reale ndërmjet matësve inteligjentë dhe qendrës së kontrollit, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave të sakta mbi konsumin e energjisë, monitorimin e tensionit dhe cilësisë së furnizimit, si dhe zbulimin e humbjeve apo keqpërdorimeve në rrjet. NES kontribuon gjithashtu në optimizimin e ngarkesës dhe përmirësimin e efikasitetit të shpërndarjes. Nëpërmjet këtyre funksioneve, sistemi NES ndihmon në krijimin e një rrjeti më të besueshëm, efikas dhe transparent të energjisë elektrike.
3. **Sistemi Mobiread** është platforma për administrimin e procesit të leximit të matësve të energjisë elektrike në të gjithë Shqipërinë. Luan një rol të rëndësishëm në mbledhjen efikase dhe të automatizuar të të dhënave nga matësit e energjisë elektrike, duke përdorur aparatet

mobile PDA. Mobiread rrit efikasitetin operacional, zvogëlon gabimet njerëzore gjatë leximit manual dhe përshejton procesin e faturimit. Gjithashtu mundëson ruajtjen dhe dërgimin e të dhënave në mënyrë të sigurt në sistemin qendror, duke e bërë menaxhimin e të dhënave më të lehtë dhe më të besueshëm.

4. **Sistemi Billing&CRM i OSHEE Group** sh.a, është sistemi kryesor përmes të cilit katër kompanitë kryejnë proceset kryesore që lidhen me infrastrukturën dhe rrjetin energjistik, abonentët, faturimin periodik dhe arkëtimin e të ardhurave, printimin e faturave etj. Nga pikëpamja funksionale, ndërfaqja e sistemit është e organizuar në modulet e mëposhtme: a) Leximi i matësave b) Menaxhimi i workforcë-s c) Portali i Selfcare-t. d) Sistemi i Menaxhimit të Informacionit e) Ndërprerjet dhe Mbylljet. f) Shërbimi ndaj Klientit. g) Lidhje e re. h) Pagesat. i) Faturim. j) Konfigurime. k) Sistemi i Balancimit të Energjisë. Përmes sistemit të Billing&CRM dhe integritet të tij me sisteme të tjera, OSHEE Group-it i mundësohet kryerja e proceseve thelbësore si, grumbullimi dhe administrimi i të dhënave të abonenteve dhe infrastrukturës së rrjetit energjistik, realizon kryerjen e proceseve të leximit/ faturimit/arkëtimin të abonentëve, gjenerimit dhe printimit të faturave të energjisë etj. Proçese si çelja e kontratës së një abonenti, hedhja dhe marrja e leximit mujor, përpunimi i leximit deri në gjenerimin e faturës, printimin e faturave, menaxhimin e matësave, krijimin e lidhjeve të reja dhe menaxhimin e të dhënave të abonentit, hedhja e pagesave, administrimi i debitorëve, krijimi i aktmarrëveshjeve, ndërprerjet, ankesë/kërkesat, workforca etj janë proçese thelbësore për mbarrëvajtjen e punës në katër kompanitë. Gjithashtu, nëpërmjet modulit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, kompanitë marrin raportime analitike dhe sintetike mbi situatën e proçeseve.
5. **Sistemi i Fiskalizimit S-Connect** përfaqëson një platformë digjitale të avancuar, e zhvilluar me synimin për të modernizuar dhe automatizuar procesin e deklarimit dhe monitorimit të transaksioneve financiare në kohë reale. Ky sistem garanton fiskalizimin elektronik të faturave të energjisë elektrike të lëshuara nga OSHEE Group, duke mundësuar transmetimin e menjëhershëm dhe të sigurt të të dhënave në sistemin e administratës tatimore. S-Connect kontribuon në rritjen e transparencës, forcimin e kontrollit financiar dhe përmirësimin e eficiencës administrative, në përputhje me kuadrin ligjor për fiskalizimin në Republikën e Shqipërisë. Zbatimi i kësaj platforme digjitale është një hap domethënës drejt dixhitalizimit të plotë të proceseve të faturimit dhe pajtueshmërisë fiskale.
6. **Sistemi i Menaxhimit të Aseteve IBM® Maximo®** është sistem i menaxhimit të ciklit jetësor të asetëve dhe i menaxhimit të procesit të rrjedhës së punës. OSHEE, përmes këtij sistemi mundëson përpunimin e të dhënave të pajisjeve teknike për të përmirësuar shërbimin ndaj klientit dhe për të optimizuar investimin në pajisje teknike të rrjetit të shpërndarjes në tensionet TL dhe TM/TU (Nënstacion-Fider-Kabinë dhe Linjat) dhe shërbimet e lidhura me mirëmbajtjen e tyre. Në sistem janë implementuar procedurat operationale në sektor për menaxhimin e pajisjeve teknike si dhe janë automatizuar proceset e punës të lidhura me to. Procedurat operationale të implementuara përfshijnë proceset që ndiqen nga punonjësit për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes, kontrolleve periodike, riparimit të defekteve, si dhe orkestrimin e mjeteve dhe burimeve njerëzore për përgatitjen dhe ekzekutimin e urdhrave të punës.
7. **SAP ERP** është platforma kryesore që OSHEE përdor për menaxhimin financiar dhe kontabël të burimeve të saj. Nëpërmjet këtij sistemi, sigurohet kontroll i plotë dhe transparencë në menaxhimin financiar, duke përfshirë kontabilitetin e përgjithshëm, lëvizjet bankare, raportimin tatimor dhe analizat e performancës financiare. SAP ERP shërben gjithashtu si themeli për

menaxhimin e aseteve fikse, kontrollin e inventarit dhe gjurmimin e lëvizjeve në të gjitha njësitë magazinuese, si në nivelin qendror ashtu edhe në ato rajonale.

8. **Sistemi i Dëmit Ekonomik** është një platformë funksionale që mundëson menaxhimin e plotë të proceseve të lidhura me faturimin dhe trajtimin e dëmeve ekonomike. Përmes këtij sistemi realizohen të gjitha veprimet kryesore që përfshihen zakonisht në një proces të rregullt faturimi, si regjistrimi dhe modifikimi i konsumit, arkëtimi dhe anulimi i pagesave, përfshirja e subjekteve në aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve, regjistrimi dhe ndjekja e ankesave, si dhe raportimi analitik dhe operacional i veprimeve të kryera. Sistemi siguron gjurmueshmëri të plotë, transparencë në çdo hap dhe një trajtim të strukturuar të rasteve të dëmit ekonomik, duke rritur ndjeshëm efikasitetin operativ dhe monitorimin e detyrimeve të prapambetura.
9. **Sistemi GIS** luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e menaxhimit të sistemit të shpërndarjes, duke ofruar një pamje të qartë dhe interaktive gjeografike të infrastrukturës ekzistuese. Përmes vizualizimit të të dhënave në hartë, ky sistem u mundëson menaxherëve dhe inspektorëve të kenë një kuptim më të thelluar dhe të saktë të shpërndarjes së rrjetit, vendndodhjes së aseteve kritike, si dhe lidhjeve ndërmjet elementeve të ndryshme të tij.
10. **Sistemi Flare HR & Payroll** është një platformë mbështet menaxhimin efikas të proceseve të punës së burimeve njerëzore dhe të pagave në të katër kompanitë tona. Përmes këtij sistemi mundësohet administrimi i të dhënave themelore për secilën kompani, si dhe i informacionit të detajuar për çdo punonjës, duke përfshirë të dhënat personale, kontratat e punës, oraret dhe kohën e angazhimit. Gjithashtu, sistemi siguron përlllogaritjen e saktë dhe në kohë të pagave, duke marrë parasysh kushte të ndryshme pune dhe përshtatjet e vazhdueshme sipas ndryshimeve në legjislacionin në fuqi. Përveç kësaj, Flare HR & Payroll mundëson menaxhimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar, si dhe ndjekjen dhe vlerësimin e performancës së punonjësve, duke e bërë atë një mjet të domosdoshëm për menaxhimin modern të burimeve njerëzore.
11. **Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore** është një platformë dixhitale që synon organizimin, ndjekjen dhe administrimin efikas të të gjitha çështjeve ligjore që lidhen me aktivitetet e kompanisë. Ky sistem automatizon procesin e regjistrimit dhe dokumentimit të çështjeve gjyqësore. Ai siguron akses të centralizuar dhe të përditësuar në të dhënat juridike.
12. **Aplikacioni Mobile i OSHEE Group sh.a** është aplikacioni zyrtar i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) në Shqipëri. Përmes tij përdoruesit të cilët janë klientë të OSHEE-s mund të kryejnë shërbime online, të shikojnë fatura, konsum dhe të ndërveprojnë me shërbimin ndaj klientit në mënyrë elektronike.
 - Regjistrimi dhe krijimi i një llogarie online pranë OSHEE-së.
 - Shikimi i faturave mujore të energjisë elektrike, dhe përgjithësisht i historikut të faturave.
 - Pagesa e faturave direkt nga aplikacioni, pa komision.
 - Krijimi i kërkesave ose ankesave për shërbim ndaj klientit, dhe ndjekja e statusit të tyre.
 - Denoncim abuzimesh ose raportimi të incidenteve në rrjetin elektrik.
 - Akses në informacion për qendrat e kujdesit ndaj klientit, dhe lajmet e fundit nga OSHEE.

Megjithëse këto sisteme kryejnë funksionet e tyre bazë, ekzistojnë problematika të rëndësishme:

1. **Mungesa e integritetit** mes sistemeve të ndryshme
2. **Procese manuale** që konsumojnë kohë dhe burime
3. **Gabime njerëzore** në leximin dhe procesimin e të dhënave
4. **Vonesa në identifikimin** e problemeve operacionale
5. **Cilësi e dobët e të dhënave** që ndikon në saktësinë e analizave
6. **Shërbim jo optimal** ndaj klientëve

Këto problematika shkaktajnë:

- Kosto të larta operacionale
- Ankesa të klientëve
- Humbje financiare
- Mungesë transparence në procese
- Vështirësi në planifikimin strategjik

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

- Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi dhe implementimi i një platforme të integruar të Inteligjencës Artificiale, e cila do të shërbejë si mjet mbështetës, analitik dhe operativ për operatorët e OSHEE Group. Platforma synon të mundësojë:
- Mbështetje të vendimmarrjes nëpërmjet analizave të avancuara dhe përpunimit inteligjent të të dhënave
- Sugjerime automatike dhe të personalizuar për proceset operacionale
- Konfirmim të detyrueshëm nga operatori për çdo veprim automatik që mund të ndikojë në proceset kritike
- Analizë dhe monitorim në kohë reale të sistemeve ekzistuese
- Raportim të vazhdueshëm dhe monitorim të performancës së proceseve dhe rekomandimeve
-
- Platforma e Inteligjencës Artificiale do të funksionojë si një asistent inteligjent, i cili:
-
- Nuk zëvendëson vendimmarrjen njerëzore, por e mbështet dhe e përmirëson atë
- Kërkon konfirmim manual përpara ekzekutimit të çdo veprimi kritik

-
- Ofron rekomandime të bazuara në analiza të dhënash, algoritme IA dhe modele prediktive
 - Kryen monitorim të vazhdueshëm të proceseve operacionale
 - Gjeneron insights të vlefshme për optimizim dhe përmirësim të vazhdueshëm

-

2.2. Objektivat Specifikë

-

- Objektivat specifike të projektit janë:

1. Krijimi i një motori inteligjent analitik (AI Engine) që përpunon të dhënat e sistemeve operative të OSHEE në mënyrë të vazhdueshme.
2. Automatizimi i analizave operacionale për proceset kritike si: matjet, rrjeti, mirëmbajtja, ndërprerjet, ngarkesat, balancimet, etj.
3. Ndërtimi i një paneli monitorimi në kohë reale (Real-Time Monitoring Dashboard) të integruar me sistemet ekzistuese.
4. Implementimi i një moduli rekomandues (Recommendation Engine) që sugjeron veprime operative bazuar në modele IA.
5. Krijimi i mekanizmit të konfirmimit nga operatori (Human-in-the-loop) për çdo veprim që kërkon aprovimin e njeriut.
6. Integrimi i platformës IA me sistemet ekzistuese (GIS, SAP, Maximo, Billing/CRM, AMI, etj.) duke siguruar shkëmbim të sigurt të të dhënave.
7. Automatizimi i raportimit periodik dhe krijimi i raporteve inteligjente mbi performancën, trendet dhe parashikimet.
8. Rritja e efikasitetit operacional përmes eliminimit të proceseve manuale dhe reduktimit të gabimeve njerëzore.

-

2.3. Rezultatet e Pritura

-

- Me përfundimin e projektit priten rezultatet e mëposhtme:

-

- **Rezultate teknike:**

- Platformë e integruar IA plotësisht funksionale, e lidhur me sistemet operative të OSHEE.
- Dashboard-e monitorimi në kohë reale me performancë të lartë.
- Motor rekomandimi që sugjeron veprime operative me bazë të dhënash dhe modele prediktive.

-
- Mekanizëm i sigurt konfirmimi nga operatorët për veprime kritike.
 - Automatizim i proceseve analitike dhe përgatitjes së raporteve.
 -
 - **Rezultate operacionale:**
 - Vendimmarrje më e shpejtë dhe e bazuar në të dhëna.
 - Rritje e efikasitetit në menaxhimin e rrjetit dhe matjeve.
 - Ulje e kohës së identifikimit dhe trajtimit të problemeve operative.
 - Reduktim i gabimeve manuale dhe rritje e standardizimit të proceseve.
 - Rritje e transparencës në raportim dhe monitorim të performancës.
 -
 - **Rezultate strategjike:**
 - Vendorsja e themeleve për transformimin digjital të OSHEE Group.
 - Përmirësim i planifikimit strategjik përmes analizës së të dhënave dhe parashikimeve.
 - Rritje e qëndrueshmërisë dhe kapaciteteve të menaxhimit të sistemeve kritike.
 -

2.4. Përfitimet Kryesore për OSHEE Group

-
- **Përfitime operacionale**
- Optimizim i proceseve të operimit të rrjetit dhe matjeve.
- Reagim më i shpejtë ndaj avarive, defekteve dhe ngarkesave.
- Menaxhim më i mirë i aseteve të rrjetit.
-
- **Përfitime teknike**
-
- Rritje e stabilitetit të sistemeve me monitoring në kohë reale.
- Integrim më i thelluar ndërmjet sistemeve ekzistuese.
- Reduktim i kostove të mirëmbajtjes për shkak të automatizimit dhe diagnostikimit të hershëm.
-

-
- **Përfitime për vendimmarrjen**
 - Rekomandime inteligjente bazuar në analiza historike dhe trende.
 - Raportim automatik për drejtuesit dhe departamentet operative.
 - Transparencë e lartë dhe qartësi në performancën e rrjetit.
 -

2.5. Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij projekti është krijimi i sistemit të Inteligjencës Artificiale (SIA) mbështetëse, Moduli AI - Aplikacioni Mobile për Leximin e Matësave, Moduli i Analizës së Sistemeve Ekzistuese dhe krijimi i infrastukures Fizike AI. Ndërtimi i kësaj platforme të integruar të Inteligjencës Artificiale që do të funksionojë si një mjet mbështetës dhe analize për operatorët e OSHEE.

Inteligjenca Artificiale planifikohet të aplikohet mbi çdo sistem informacioni që OSHEE ka aktualisht, si edhe mund të shtrihet mbi sistemet e reja në të ardhmen. E njëjta platforme **AI** që do të ndërtohet sot, do të trajnohet në të ardhmen me informacione/sisteme/te dhëna të reja pa patur nevojë për ndryshime në infrastrukturë apo licencim.

Në thelb, teknologjia **AI** është projektuar të funksionojë si një agjent i kompanisë, i cili kryen rakordime, verifikime, analiza llogjike mbi të dhënat që ka OSHEE, dhe nxjerr raporte mbi problematikat e hasura, apo aktivizon automatikisht procedurat e Work Force Management për procedurat në terren. Ky agjent punon për llogaritë të OSHEE 24/7/365 dhe zëvendëson orë të tëra pune apo personel të dedikuar për shumë aspekte/procese pune të kompanisë.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Konkretisht, AI planifikohet të integrohet tek modulet si më poshtë:

1. Verifikimi i të dhënave të leximit
2. Moduli i ankesave
3. Lidhjet e reja
4. Verifikimi i ndryshimeve të dhënave të kontratës
5. Verifikime/analize llogjike mbi të dhënat e matësve smart (AMI)
6. Verifikime mbi të dhënat e sistemeve GIS
7. Lidhja me modulet Work Force Management
8. Data cleaning
9. Asistenti i Shitjes
10. Asistenti Ligjor

Qëllimi i kësaj procedure është krijimi i një sistemi AI mbështetës që do të ndihmojë operatorët e OSHEE në:

Analizën e Sistemeve Ekzistuese:

- Ekstraktimi i të dhënave nga sistemet aktuale
- Analiza e performancës operacionale
- Identifikimi i trendeve dhe pattern-ave
- Gjenerimi i raporteve analitike

Mbështetjen e Vendimmarrjes:

- Sugjerime të bazuara në të dhëna për optimizime
- Alerta për anomali që kërkojnë vëmendje
- Parashikime për planifikimin strategjik
- Dashboard-e interaktive për monitorim

Automatizimi i Leximit të Matësave:

- Leximi automatik i konsumit përmes aplikacionit mobile
- OCR i avancuar për leximin e matësave
- Validimi automatik dhe sugjerimi i korrigjimeve
- Update-e të kontrolluara në sistemet përkatëse (me konfirmim operatori)

Procese me Konfirmim Operatori:

- Asnjë veprim kritik nuk kryhet pa aprovimin e operatorit
- Workflow-e që kërkojnë konfirmim për çdo hap të rëndësishëm
- Sistemi propozon, operatori vendos
- Audit trail i plotë për të gjitha veprimet

2.6. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Rezultatet që do të duhet të arrihen nga Operatori Ekonomik përmbledhen:

- Krijimi i infrastruktures hardware për Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse (Furnizim, instalim, konfigurim)
- Ndertimi dhe implementimi i Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse.

-
- Ndertimi dhe implementimi i platformes AI per sherbimet Verifikimi i te dhenave te leximit, Moduli i ankesave, Lidhjet e reja, Verifikimi i ndryshimeve te dhenave te kontrates, Verifikime/analize llogjike mbi te dhenat e matesave smart (AMI), Verifikime mbi te dhenat e sistemeve GIS, Lidhja me modulet Work Force Management, Data cleaning, Asistenti i Shtijes, Asistenti Ligjor.
 - Trajnimin e perdoruesve (sipas metodes Trajno Trajnuesit) (Manualet e perdorimit per te gjitha modulet AI te sistemit
 - Manualet e perdorimit. Manuali konfigurimeve.
 - Testimi i sistemit te Inteligjencës Artificiale (Scripts, etj)
 - Procesi i mirembajtjes.

KPI-të Kryesore:

Efikasiteti Operacional:

- Mbështetje më e mirë e vendimmarrjes: 70%+
- Rritje e saktësisë së analizave: 95%+
- Reduktim i kohës për analiza: 80%
- Përmirësim i cilësisë së leximit: 60%

Cilësia e Operacioneve:

- Saktësi e leximit të matësave: 95%+
- Response time për analiza: nga 1 javë në 1 orë
- Identifikimi i anomalive: 90%+ accuracy
- Reduktim i gabimeve në lexim: 70%

Impakti Operacional:

- Kursim kohe për operatorët: 40-50%
- Përmirësim i cilësisë së të dhënave: 60%
- Rritje e productivitetit të ekipeve: 30%

Karakteristikat Kryesore:

- AI si mjet mbështetës, jo zëvendësues i operatorit
- Konfirmim i detyrueshëm për çdo veprim kritik
- Fokus në analiza dhe insights, jo automatizim të plotë
- Leximi i përforcuar i matësave përmes mobile app

Ky projekt do të fuqizojë operatorët e OSHEE me mjete AI të avancuara për vendimmarrje më të mirë, pa hequr dorë nga kontrolli njerëzor i proceseve kritike.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Stafi i autoriteti kontraktor, operatorit ekonomik dhe përfituesit të jenë të pavarur në punën e tyre dhe të gjindshëm në çdo rast.
- Stafi i autoriteti kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe bashkëpunues me njëri-tjetrin.
- Stafi i autoriteti kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet.
- Stafi i autoritetit kontraktor / përfituesi do të vërë në dispozicion të personelit të operatorit ekonomik të gjithë dokumentat, rregulloret, procedurat e nevojshme.
- Informacioni i shkëmbyer midis stafit të palëve mbetet konfidencial mes palëve
- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara
- Akses i plotë në sistemet ekzistuese të OSHEE
- Bashkëpunim i ekipeve teknike të OSHEE
- Disponibilitet i të dhënave historike për trajnimin e AI
- Infrastruktura e duhur IT për hostimin e platformës

3.2. Risqet

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës mes stafit të perfshire.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik fitues në projekte të tilla.
- Dokumentimi jo i mirë i sistemit.
- Mos respektimi i afateve kohore nga operatori ekonomik fitues.
- Kompleksiteti i integritetit me sistemet ekzistuese
- Rezistenca ndaj ndryshimit nga personeli
- Cilësia e dobët e të dhënave të mëparshme
- Ndryshime në kërkesat gjatë implementimit
- Vështirësi në kalibrimin e algoritmeve AI

4. FUSHA E PUNËS (SCOPE OF WORK)

Fusha e punës përfshin projektimin, zhvillimin, implementimin dhe operimin fillestar të platformës së Inteligjencës Artificiale, si dhe integrimin e saj me sistemet operative të OSHEE Group. Përfshin këto komponentë kryesorë:

4.1. Projektimi dhe Arkitektura e Sistemit

- Analiza e sistemeve ekzistuese (SAP, GIS, Maximo, Billing/CRM, AMI, etj.).
- Projektimi i arkitekturës teknike të platformës IA.
- Përcaktimi i burimeve të të dhënave, strukturave dhe mënyrës së integrimit.

4.2 Zhvillimi i Motorit Analitik (AI Engine)

- Ndërtimi i modeleve të analizës, sinjalizimit, parashikimit dhe rekomandimit.
- Trajnimi i modeleve IA me të dhënat historike dhe operative.
- Implementimi i mekanizmave të feedback-ut nga operatorët.

4.3 Integrimi me Sistemet Operative

- Ndërtimi i API-ve ose konektorëve për komunikim me sistemet kryesore. (Middleware)
- Sigurimi i shkëmbimit në kohë reale të të dhënave.
- Menaxhimi i cilësisë së të dhënave dhe transformimit të tyre.

4.4 Mekanizmi i Interaksionit me Operatorin

- Implementimi i funksionit “*human-in-the-loop*” për verifikim veprimesh.
- Regjistrimi dhe auditimi i të gjitha ndërveprimeve të operatorit.
- Menaxhimi i roleve dhe aksesit.

4.5 Testimi dhe Validimi

- Testim funksional, performancë dhe siguri.
- Testim i integriteteve ndër-sistimore.

-
- Testim UAT me përdoruesit operativë të OSHEE Group.

4.6. Trajnimet dhe Dokumentacioni

- Trajtime për operatorët dhe përdoruesit finalë.
- Dokumentacion teknik, operacional dhe manuale përdorimi.
- Dorëzimi i udhëzuesve për mirëmbajtje dhe konfigurim.

4.7. Mbështetja Fillestare Operacionale

- Mbështetje gjatë fazës “Go-Live”.
- Monitorim dhe optimizim gjatë 3 muajve të parë.
- Rregullime dhe përmirësime pas Go-Live sipas feedback-ut të përdoruesve.

Projekti duhet të bazohet në teknologjitë më të avancuara të Inteligjencës Artificiale dhe Machine Learning, duke përfshirë:

- Computer Vision për analizimin e fotove të matësve
- Natural Language Processing për procesimin e ankesave
- Predictive Analytics për parashikimin e konsumit
- Anomaly Detection për identifikimin e problemeve
- Process Mining për optimizimin e workflow-ve
- Etj..

4.8 Përshkrimi i detyrës

Detyra e Operatori Ekonomik është krijimi dhe implemetimi i sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse (OSHEE-AI) duke:

- Krijimi i infrastruktures hardware për Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse (Furnizim, instalim, konfigurim) (pranë OSHEE Datacenter). OE duhet të bëjë furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e të gjithë infrastrukturës hostuese.
- Ndertimi dhe implementimi i sistemit Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse.
- Ndertimi dhe implementimi i platformes AI për shërbimet Verifikimi i të dhënave të leximit, Moduli i ankesave, Lidhjet e reja, Verifikimi i ndryshimeve të dhënave të kontratës, Verifikime/analize llogjike mbi të dhënat e matësve smart (AMI), Verifikime mbi të dhënat e sistemeve GIS, Lidhja me modulet Work Force Management, Data cleaning, Asistenti i Shtijes, Asistenti Ligjor.

- Trajnimin e përdoruesve (sipas metodës Trajno Trajnuesit)
- Manualët e përdorimit për të gjitha modulet AI të sistemit
- Procesi i mirëmbajtjes për një periudhë 2 vjeçare.

4.9 Siguria e sistemit

Sistemit të Inteligjencës Artificiale duhet të jetë i qëndrueshëm e i besueshëm dhe të ofrojë në çdo kohë kontroll të integritetit dhe plotësisë së informacionit dhe i garantuar nga ndërhyrjet e pautorizuara. Sistemi duhet të lejojë akses vetëm për personat e autorizuar, me të drejtat e përcaktuara në këtë sistem.

Rolet informatike të përdoruesve në sistemin e përmirësuar do të vihen në korrespondencë me funksione, institucionale të përdoruesve të tij.

Operatori Ekonomik duhet të realizojë implementimin e Single Sign On (SSO) nëpërmjet ENTRA ID duke ndjekur protokollin OIDC, një zgjidhje e implementuar në infrastrukturën e OSHEE-së. User-at për përdoruesit e sistemit duhet të tërhiqen nga Active Directory “oshee” dhe roli përkatës duhet të përcaktohet në sistem. Metoda/Platforma e përzgjedhur për përmirësimin e sistemit duhet të suportojë implementimin e ENTRA ID SSO.

Vetëm mbas identifikimit të tij si përdorues me të drejtat plotësisht të përcaktuara, ai (përdoruesi) mund të hyjë në sistem dhe të punojë vetëm mbi ato funksione, detyra të bazuara mbi të drejtat (access-in) të përcaktuara nga administratori.

Të drejtat e çdo roli do të përcaktohen nga Administratori i sistemit në përputhje me nevojat për akses në të dhëna dhe funksione të rolit.

Niveli i sigurisë së sistemit, sipas klasave të disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit është përcaktuar duke u bazuar në VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore” të ndryshuar, është L-D3I3K2, sipas tabelës së mëposhtme:

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
☐ D0	☐ I0	☐ K0	
☐ D1	☐ I1	☐ K1	☐ U
☐ D2	☐ I2	☐ K2	☐ M
☐ D3	☐ I3		☐ L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmeria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.

Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

E gjithë infrastruktura perberese e sitemit duhet te Patch-ohet dhe te kryhen Update ne menyre te paracaktuar sipas Rregullore per sigurine e Informacionit per te shmangur ekspozimin ndaj vulnerabiliteteve per nje kohe te gjate.

Operatori ekonomik fitues duhet te kete parasysh dhe rregullore te tjera te sigurise te nxjerra nga Autoriteti Kombetar per Sigurine Kibernetike (AKSK), te cilat duhet te jene pjese integrale e funksionaliteteve dhe konfigurimeve te sitemit, ne menyre qe te permbushet zbatimi i tyre.

4.10 Detyrat specifike

Operatori Ekonomik fitues ka si detyrë realizimin e projektit duke kaluar neper disa faza kryesore:

- **FAZA I: Faza përgatitore, analizimi i kërkesave dhe bazes ligjore**

Kjo fazë fillon menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe në të do të bëhet:

- Analizë e plotë e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore, proceset ekzistuese, se bashku me kërkesat e sitemit;
- Analizë e të gjithë moduleve ekzistuese, nderveprimet e nevojshme në përshtatje me kërkesat e këtyre termave;
- Analizë e problematikave të hasura ndër vite nga aktorët e përfshirë në procese të ndryshme të punës;

- **FAZA II: Zhvillimit të sistemin software dhe krijimi i infrastruktures fizike**

Në këtë fazë duhet të realizohen zhvillimi i sistemit Software Te Inteligjences Artificiale dhe të gjitha moduleve përkatëse të kërkuara sipas kërkesave të këtyre termave dhe ndonjë përmirësimi që mund të ketë dalë gjatë fazës së analizimit.

- Krijimi infrastruktures hardware (prane OSHEE Datacenter). OE duhet te bej furnizimin, instalimin dhe konfigurim e te gjithë infrastrukturës hostuese.
- Ndertimi dhe implementimi i sistemit Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse.
- Ndertimi dhe implementimi i platformes AI per sherbimet Verifikimi i te dhenave te leximit, Moduli i ankesave, Lidhjet e reja, Verifikimi i ndryshimeve te dhenave te kontrates, Verifikime/analize llogjike mbi te dhenat e matesave smart (AMI), Verifikime mbi te

dhenat e sistemeve GIS, Lidhja me modulet Work Force Management, Data cleaning, Asistenti i Shtijes, Asistenti Ligjor.

- Moduli i Analizës së Sistemeve Ekzistuese.

- **FAZA III: Testimi dhe trajnimi**

Testimet duhet të bëhen për të verifikuar funksionalitetin, për qëndrueshmëri, efikasitet, performancë, debug, etj.

Në kuadrin e këtij projekti duhet patur parasysh në mënyrë të veçantë dhe trajnimet që do t'i bëhen personelit sipas moduleve specifike, e sipas rolit që kanë në sistem. Trajnimi duhet të bëhet sipas metodës 'Trajno Trajnuesit'.

- **FAZA IV: Marrja në dorëzim e sistemit**

Pasi të gjithë modulet e Sistemit të Inteligjencës Artificiale (SIA) mbështetëse të jenë testuar, do të bëhet marrja në dorëzim e sistemit SIA.

- Marrja në dorëzim e sistemit SIA do të bëhet pas përfundimit me sukses të procesit të testimit. Testimet do të realizohen në ambientin test për të gjitha proceset e punës, për çdo modul të SIA dhe për çdo integrim me sistemet e tjera.

- **FAZA V: Mirëmbajtje**

Mirëmbajtje e sistemit të përmirësuar do të jetë për një periudhë 2 vjeçare, që nga momenti i marrjes në dorëzim.

Ndërtimi i Moduleve AI Mbështetës:

1. Moduli i Analizës së Sistemeve Ekzistuese

- Ekstraktimi i të dhënave nga sistemet aktuale
- Analiza e performancës dhe identifikimi i problem-eve
- Gjenerimi i raporteve analitike
- Dashboard për monitorimin e KPI-ve

2. Moduli i Leximit Automatik të Matësave (Mobile)

- Aplikacion mobile për leximin e matësave
- OCR i avancuar për leximin e konsumit

-
- Validimi automatik dhe sugjerimi i korrigjimeve
 - Update i kontrolluar në sisteme (ME KONFIRMIM OPERATORI)

3. Moduli i Mbështetjes së Vendimmarrjes

- Analiza e trendeve dhe pattern-ave
- Sugjerime për optimizime operacionale
- Alerta për anomali që kërkojnë vëmendje
- Rekomandime të bazuara në të dhëna

4. Moduli i Raportimit dhe Monitorimit

- Dashboard-e interaktive në kohë reale
- Raporte të personalizuar sipas nevojave
- Export në formate të ndryshme
- Alert-e automatike për situata kritike

5. Moduli i Workflow-eve me Konfirmim

- Procese që kërkojnë aprovim nga operatori
- Sistemi propozon, operatori vendos
- Audit trail i plotë për transparencë
- Notifikime për veprime që presin konfirmim

6. Moduli i Analizave Parashikuese

- Forecasting i konsumit të energjisë
- Parashikimi i nevojave për mirëmbajtje
- Analiza e riskut për problematika teknike
- Planifikimi optimal i burimeve

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Infrastruktura, ku do të jetë i hostuar Sistemi të Inteligjencës Artificiale (SIA) do të jetë në Datacenteri e OSHEE-së në zyrat qendrore Tiranë..

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 7 muaj nisur nga kjo datë dhe 2 vjet mirëmbajtja.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në original dhe 1 kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 8 faqesh duhet të prodhohet brenda 10 ditësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të perbehet prej 10 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset)...]. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 20 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.
- **Raporti periodik mujor** mbi shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit në tërësi. Operatori duhet të dokumentojë çdo ndryshim duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjes dhe duhet të marrë aprovimin e stafit përgjegjës për çdo ndërhyrje.

Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë çdo informacion tjetër të rëndësishëm si psh:

- 1- Raport instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit.

Inventari (HW, SW, etj.)

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës të identifikuar në kontratë. Grupi i punës është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemi i përmirësuar duhet të jetë në gjendje të ekspozojë të dhëna në përputhje me standardet e përdorura në Platformën OSHEE MIDDLEWARE të Ndërveprimit, si dhe të mund të presë të dhëna të sistemeve të tjera elektronike kur ato mundësohen nëpërmjet Platformës OSHEE MIDDLEWARE.

Ky sistem do të ketë komunikim me sistemet e brendshme të vetë OSHEE-së si me poshtë :

- Sistemi i Billing/CRM për menaxhimin e klientëve dhe faturimin
- Sistemi Mobiread për leximin e matësave përmes fotografive
- Sistemi GIS për menaxhimin gjeografik të infrastrukturës
- Sistemi i Work Force Management për koordinimin e ekipeve
- Etj..

Ne analizen e Biznesit do të percaktohen të gjitha sistemet e nevojshme.

8. GARANCIA

Garancia e pajisjeve hardware do të jetë sipas secilit model të paraqitur të specifikimet teknike në pikën 14.

9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 2 vjeçare, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “ Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të

keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej 2 orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me Autoritetin Kontraktor dhe perfituesin një axhendë periodike kontrollesh mujore si më poshtë:

1. Javore

- a. Kontroll i logeve të pajisjeve fizike.
- b. Kontroll i statistikave të hapësirave server/storage (Hapësira e përdorimit të HDD-ve, etj).
- c. Kontroll i statistikave për sistemin.
- d. Kontroll i pajisjeve për probleme.
- e. Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirembajtje parandaluese dhe parashikuese për makinat dhe pajisjet.
- f. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

2. Mujore.

- a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
- b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware/software.
- c. Rishikim i të dhënave mbi performancë e serverave.

- d. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.
- e. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Njesia	Cmimi	Vlera Totale
1	Implementimi i Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse	1	set		
2	Implementimi I Modulit AI ne Aplikacionin Mobile OSHEE	1	set		
4	Integrimet me Sistemet Ekzistuese	5	sisteme		
5	Server AI (Inteligjencës Artificiale)	2	cope		
6	Instalim, konfigurim i pajisjeve fizike	1	set		
7	Trajnim i përdoruesve	15	dite		
8	Mirëmbajtja e Platformës së Inteligjencës Artificiale software dhe hardware	24	muaj		

11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Përmirësimi i Sistemit të Inteligjencës Artificiale do të shtrihet brenda një periudhë 7 mujore.

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5-M6	M7	M8-M31
1	Faza Përgatitore për sistemin software të Inteligjencës Artificiale							
2	Lëvrimi i pajisjeve hardware							

3	Faza e zhvillimit të sistemin software të Inteligjencës Artificiale							
4	Faza e integrimit me sistemet ekzistuese dhe testimit të sistemit software							
5	Trajnimi i përdoruesve							
6	Marrja në dorëzim							
7	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes							

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të sistemit apo pajisjeve, skica, etj.) do t'i përkasin OSHEE si pronar i plotë i platformës. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar për çdo modul dhe për sistemin në tërësi, së bashku me setin e dokumentacionit teknik. Kodi burim duhet të dorëzohet i plotë pas implementimit të sistemit dhe i përditësuar sa herë që mund të bëhen ndryshime gjatë fazës së mirëmbajtjes, në fund të kësaj periudhe.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Kërkesat funksionale të listohen sipas moduleve që do ndërtohen

ARKITEKTURA TEKNIKE - PLATFORMA AI PËR OSHEE



13.1. Funksionalitete dhe Blokskema

Inteligjenca Artificiale si një agjent i institucionit do të përmirësojë proceset duke u integruar në modulet si më poshtë vijon:

13.1.1 Moduli i verifikimit të të dhënave nga skanimi i matësve elektrikë

Ky modul luan rol kyç në sistemin e menaxhimit të matësve elektrikë, pasi ka për qëllim garantimin e saktësisë së të dhënave të leximit që mbledhen nga infrastruktura e matjes automatike.

Inteligjenca Artificiale do ta ndihmojë sistemin të kryejë analiza të avancuara mbi të dhënat historike dhe aktuale të konsumit, me synim zbulimin e anomalive, identifikimin e leximeve të dyshimta dhe parandalimin e gabimeve që mund të ndikojnë në proceset e faturimit apo raportimit operativ.

Përdorimi i modeleve të mësimi makinerik (Machine Learning), si Autoencoder, Isolation Forest, dhe algoritme klasifikimi, mundëson diferencimin automatik midis leximeve “normale” dhe atyre “të dyshimta”, duke sinjalizuar rastet që kërkojnë verifikim manual ose analizë të mëtejshme.

Kjo qasje jo vetëm që rrit saktësinë e të dhënave dhe shmanget kostot e gabimeve, por gjithashtu krijon bazën për procesim të automatizuar dhe inteligjent të informacionit, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve dhe efikasitetin operativ të institucionit.

Përdorimi i IA:

Teknikat IA	Përfitimi
-------------	-----------

Machine Learning (ML) për zbulim anomalie	Detekton lexime të pamundura, konsum të pazakontë
Autoencoder / Isolation Forest	Zbulon vlera outlier në konsum
Klasifikim me ML (Normal / eDyshimtë)	Vlerëson besueshmërinë e leximeve

Shembull:

- IA vëren që një klient me konsum mesatar 300 kWh/muaj ka lexime prej 1200 kWh. Sistemi sinjalizon për verifikim ose aktivizon algoritmin e parashikimit për krahasim.
- IA përpunon foton e dërguar nga middleware dhe kryen leximin e treguesit të matësit si edhe numrit serial të tij.
- IA kryen krahasimin vizual të matësit që ka abonenti për të siguruar që matësi nuk është ngatërruar nga operatori me matësin e një abonenti tjetër.

Aktorët:

- OSHEE Middleware
- API Gateway
- Cache Storage
- Modeli LLM
- Modeli OCR

Hapat e procesit:

1. OSHEE Middleware dërgon foton e matësit tek API Gateway
2. API Gateway kontrollon nëse imazhi është skanuar më parë
3. Nëse nuk gjendet në cache, dërgohet për lexim te modeli LLM dhe OCR
4. Extract-ohen tekstet dhe llogaritet saktësia e përgjigjes
5. Përgjigjja ruhet në cache për përdorim të ardhshëm
6. Kthehet përgjigjja tek OSHEE Middleware

Diagrami tregon dy rrugë të mundshme:


Fruga e shpejtë: Kur imazhi gjendet në cache (hapi 2 → 6 direkt)

Fruga e plotë: Kur imazhi duhet procesuar nga fillimi (të gjithë hapat 1-6)

Në të gjitha përgjigjet shërbimi do të kthejë një vlerë (0-100) saktësie të leximit, në rastet kur imazhi nuk është i lexueshem vlera do të jetë 0.

Do të ofrohet mundësia e kontrollit të matësit (kontroll vizual) që të përkojë me matësin që abonenti ka patur gjatë kontrolleve të mëparshme.

Të gjitha rastet problematike do të analizohen manualisht duke përdorur panelin e kontrollit. Në rastet ku është e mundur do të kryhen optimizime të modelit dhe aplikacionit për të kryer leximin e rasteve specifike.



13.1.2 Modul per procesim automatik ankesash

Ky modul është menduar për të menaxhuar në mënyrë inteligjente ankesat që lidhen me keqfaturimin e konsumit të energjisë elektrike. Ai analizon automatikisht të dhënat e faturimit, leximet nga matësat (AMI) dhe historikun e konsumit për secilin klient.

Qëllimi kryesor është të identifikojë shpejt shkakun e mundshëm të gabimit qoftë teknik, operacional apo njerëzor dhe të ofrojë zgjidhje të bazuara në të dhëna të verifikueshme.

Nëpërmjet përdorimit të Inteligjencës Artificiale (IA), moduli do të aplikojë algoritme të mësimi makinerik (Machine Learning) për të analizuar lidhjet mes leximeve mujore, tarifave dhe ndryshimeve në sjelljen e konsumit, duke zbuluar automatikisht çdo anomali në faturim. Njëkohësisht, teknikat e përpunimit të gjuhës natyrore (Natural Language Processing - NLP) do të mundësojnë analizimin automatik të përmbajtjes së ankesës së klientit, duke identifikuar fjalët kyçe që tregojnë natyrën e problemit dhe nivelin e pakënaqësisë.

Në rastet kur IA vëren mospërputhje ndërmjet të dhënave të leximit dhe faturimit, sistemi mund të:

- Sinjalizojë automatikisht për verifikim manual
- Sugjerojë rillogaritjen e faturës, ose
- Aktivizojë algoritmin e parashikimit për të krahasuar konsumin aktual me atë historik të klientit.


Kjo zgjidhje mundëson një trajtim më të shpejtë, të drejtë dhe të dokumentuar të ankesave për keqfaturim, duke reduktuar ndjeshëm kohën e përpunimit dhe duke rritur besimin e klientëve ndaj institucionit.

Përdorimi i IA:

Teknikat IA	Përfitimi
Natural Language Processing (NLP)	Analizon automatikisht përmbajtjen e ankesave tekstuale
Sentiment Analysis	Kupton nëse klienti është shumë i pakënaqur
Rregulla logjike + ML	Kros-verifikon me AMI/GIS dhe sugjeron zgjidhje ose prioritete

Shembull:

Ankesa për faturim: IA analizon të dhënat matësit elektrik dhe sugjeron nëse është e justifikuar ose nëse leximi është anomali.



13.1.3 Moduli i Lidhjeve të Reja

Falë përdorimit të teknologjive të Inteligjencës Artificiale (IA) në këtë modul, sistemi do të analizojë automatikisht dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit, do të vlerësojë sa e saktë dhe e plotë është kërkesa, si dhe do të kontrollojë mundësinë teknike për realizimin e lidhjes bazuar në të dhënat gjeohapësinore (GIS).


Algoritmet Decision Tree dhe Rule-Based AI automatizojnë procesin e vendimmarrjes për aplikimet që janë të plota dhe përmbushin kriteret, ndërsa integrimi i Geospatial AI me sistemet GIS mundëson vlerësimin automatik të distancës nga rrjeti elektrik dhe kapacitetin e zonës për të përballuar lidhje të reja. Në të njëjtën kohë, kombinimi i OCR (Optical Character Recognition) dhe NLP (Natural Language Processing) lejon leximin automatik të dokumenteve të ngarkuara nga klientët dhe nxjerrjen e informacionit thelbësor që nevojitet për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës.

Në praktikë, kjo nënkupton që, për çdo aplikim të ri për lidhje elektrike, IA kontrollon dokumentet, verifikon kapacitetin e rrjetit në GIS, dhe nëse aplikimi është i vlefshëm, gjeneron automatikisht një detyrë (task) për ekipin përkatës të menaxhimit të punimeve në terren (WFM).

Teknikat IA	Përfitimi
Decision Trees / Rule-Based AI	Automatizon vendimmarrjen nëse aplikimi është i plotë dhe korrekt
Geospatial AI + GIS	Vlerëson distancën nga rrjeti dhe kapacitetin e zonës
OCR + NLP	Lexon automatikisht dokumentet e ngarkuara nga aplikuesi

Shembull:

Klienti aplikon për lidhje të re: IA verifikon automatikisht dokumentet, kontrollon në GIS nëse zona ka kapacitet, dhe krijon task për ekipin WFM.



13.1.4 Moduli i Verifikimit të Ndryshimeve në Kontratë

Nëpërmjet automatizimit të procesit të verifikimit dhe përdorimit të teknologjive të Inteligjencës Artificiale (IA), sistemi do të garantojë kontroll të plotë mbi vlefshmërinë e kërkesave, duke reduktuar rrezikun e abuzimeve, gabimeve njerëzore dhe vonesave në përpunim.

Përdorimi i Document AI dhe OCR (Optical Character Recognition) do të mundësojë leximin automatik të dokumenteve kontraktuale, identifikimin e ndryshimeve të kryera dhe krahasimin e versioneve përkatëse për të verifikuar saktësinë dhe legjitimitetin e tyre. Gjithashtu, komponenti i Anomaly Detection ndihmon në zbulimin e ndryshimeve të pazakonta apo jologjike, si për shembull kërkesa për ulje të kapacitetit në një zonë me ngarkesë të lartë, ose rritje të menjëhershme të fuqisë së kontraktuar pa një arsye teknike të qartë.

Për të garantuar sigurinë e procesit, sistemi do të përdorë verifikimin e nënshkrimit digjital (Digital Signature Verification), duke u siguruar që çdo kërkesë për ndryshim të vijë nga një burim i autorizuar dhe të shoqërohet me identitetin digjital të vlefshëm të kërkuar.


Përdorimi i IA:

Teknikat IA	Përfitimi
Document AI + OCR	Lexon dhe verifikon ndryshimet e dokumenteve
Anomaly Detection	Identifikon ndryshime jo-logjike ose jo të zakonshme (psh. reduktim i kapacitetit në një zonë me ngarkesë të lartë)
Digital Signature Verification	Përdor ID digjitale për të garantuar identitetin e kërkuesit

Shembull:

Klienti ndryshon fuqinë nga 3.5 kW në 15 kW à IA kontrollon nëse konsumatori ka përdorim që justifikon ndryshimin, dhe nëse zona mbështet këtë fuqi.

Skema e përpunimit dhe analizimit e dokumentave ⁽¹⁾



13.1.5 Analizë Logjike mbi të Dhënat e Matësave Smart (AMI)

Inteligjenca Artificiale (IA) në këtë modul do të ndihmojë për të analizuar profilet e konsumit të energjisë dhe për të gjeneruar njohuri të avancuara operationale dhe parashikuese. Nëpërmjet teknikave si Time Series Forecasting, Clustering dhe Non-Technical Loss Detection ose ekuivalente, sistemi duhet të:

- Parashikojë konsumin e ardhshëm të energjisë,
- Identifikojë grupe klientësh me sjellje të ngjashme të konsumit, dhe
- Zbulojë raste të mundshme të vjedhjeve ose manipulimeve të matësave.

Kjo analizë inteligjente duhet të mundësojë optimizimin e planifikimit energjetik, reduktimin e humbjeve jo teknike dhe rritjen e saktësisë së të dhënave të rrjetit elektrik, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin operativ dhe transparencën në menaxhimin e sistemit.

Përdorimi i IA:

Teknikat IA	Përfitimi
Time Series Forecasting (LSTM, Prophet)	Parashikon konsum të ardhshëm
Clustering (K-Means, DBSCAN)	Grupon klientët sipas sjelljes së konsumit
Non-Technical Loss Detection	Zbulon vjedhje / manipulim të energjisë

Shembull:

- IA identifikon një grup konsumatorësh që kanë model të rregullt, por befas konsum 0. Flamur i kuq për kontroll të vjedhjes.

13.1.6 Verifikime mbi të Dhënat e Sistemeve GIS

Ky modul duhet të përdorë Inteligjencën Artificiale (IA) për të verifikuar saktësinë e të dhënave gjeohapësinore në sistemet GIS, duke siguruar që informacionet për rrjetin elektrik dhe vendndodhjet e klientëve të përputhen me situatën reale në terren.

Përmes Geospatial AI, sistemi duhet të krahasojë koordinatat e klientëve me rrjetin elektrik për të identifikuar mospërputhje; me Image Analysis (p.sh. pamje droni) do të detektojë instalime të paautorizuara ose zona me risk; ndërsa modeli me ML për ngarkesat zonale do të ndihmojë në parashikimin e konsumit dhe planifikimin kapacitiv sipas zonave gjeografike.

Ky modul duhet të kontribuojë në rritjen e saktësisë së hartave operationale, reduktimin e gabimeve të regjistrimit dhe përmirësimin e menaxhimit të infrastrukturës elektrike.

Teknikat IA	Përfitimi
Geospatial AI	Krahason vendndodhjen e klientëve me rrjetin elektrik
Image Analysis (drone + IA)	Detekton instalime të paautorizuara ose zona të rrezikuara
ML për zonal load prediction	Parashikon ngarkesë në zona të ndryshme gjeografike

Shembull:

Një klient është regjistruar në GIS në një segment të gabuar. IA identifikon mospërputhje midis vendndodhjes AMI dhe hartës.

13.1.7 Lidhja me modulet Work Force Management

Inteligjenca Artificiale në këtë modul duhet të integrohet për të automatizuar planifikimin, koordinimin dhe dërgimin e ekipeve të terrenit. Qëllimi do të jetë optimizimi i proceseve operative, reduktimi i kohës së reagimit dhe rritja e efikasitetit të shërbimit.

Nëpërmjet AI Scheduling Algorithms, sistemi do të caktojë automatikisht ekipet në bazë të prioritetit të ndërhyrjes, distancës dhe kapacitetit të disponueshëm. Me Predictive Maintenance, IA do të sugjerojë ndërhyrje parandaluese përpara se të ndodhin defektet, ndërsa komponenti i Resource Optimization do të sigurojë përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe ulje të kostove logjistike.

Ky integrim do të mundësojë bashkëveprim inteligjent midis të dhënave të AMI dhe GIS, duke dërguar automatikisht ekipin më të afërt dhe më të përshtatshëm për zgjidhjen e defekteve të identifikuara në rrjet.

Teknikat IA	Përfitimi
AI Scheduling Algorithms	Planifikon ekipet në bazë të prioritetit, distancës, kapacitetit
Predictive Maintenance AI	Sugjeron ndërhyrje para se të ndodhë defekti
Resource Optimization	Maksimizon përdorimin e ekipeve dhe redukton kostot logjistike

Shembull:

IA kombinon të dhënat nga AMI dhe GIS për të dërguar ekipin më të afërt për të zgjidhur një defekt të dyshuar.

13.1.8 Data Cleaning

Integrimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në këtë modul do të shërbejë në rritjen e cilësisë, saktësisë dhe koherencës së të dhënave në sistem, duke garantuar që vendimmarrja dhe analizat të bazohen në informacion të besueshëm.

Përmes Fuzzy Matching, sistemi do të zbulojë klientë ose kontrata të dyfishta, ndërsa Anomaly Detection do të bëjë identifikimin e të dhënave jonormale ose të paplota (p.sh. kontratë aktive pa lexime mujore). Algoritmet e Machine Learning do të ndihmojnë në plotësimin dhe korrigjimin automatik të të dhënave, duke sugjeruar vlera të sakta për fusha me informacion të munguar ose që përbëjnë konflikt.

Moduli do të sigurojë integritet më të lartë të bazës së të dhënave, reduktim të gabimeve operative dhe mbështetje të fortë për vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Procesi që do të aplikohet është paraqitur te skema ⁽¹⁾

Teknikat IA	Përfitimi
Fuzzy Matching	Zbulon klientë me të dhëna të dyfishta ose të

	përplasuara
Anomaly Detection	Detekton të dhëna jonormale (p.sh. kontratë aktive pa lexim për muaj)
ML për përmirësim rekordesh	Sugjeron korrigjime për fusha me vlerë të munguar ose konflikt

Shembull:

Dy kontrata të regjistruara në një adresë. IA sugjeron bashkim ose verifikim të pronësisë me Digital ID.

13.1.9 Asistenti ligjor

LegalAI do të jetë një platformë e mbështetur në inteligjencën artificiale që transformon menaxhimin e çështjeve dhe shkresave ligjore duke kombinuar analizën inteligjente të dokumenteve, kërkimin e avancuar ligjor dhe gjenerimin automatik të dokumentave.

Platforma duhet të funksionojë nëpërmjet tre hapave kryesorë:

fillimisht, të ngarkohen dhe procesohen automatikisht dokumentat e nevojshme për çështjen, si vendime gjyqësore, prova ose korrespondencë institucionale, përmes teknologjisë OCR dhe algoritmeve të inteligjencës artificiale që brenda minutash të nxjerrin të dhënat kryesore, të identifikojnë shkeljet procedurale, të llogaritën afatet ligjore dhe të krijojnë një pasqyrë të plotë të çështjes.

Së dyti, motori i kërkimit të hulumtojë në një bazë të dhënash që përfshin të gjithë legjislacionin aktual të Republikës së Shqipërisë, praktikën gjyqësore shqiptare dhe udhëzimet institucionale, duke ofruar citime të sakta, precedentë relevantë dhe argumente ligjore të bazuara në raste të ngjashme.

Së treti, platforma të gjenerojë automatikisht draft-dokumente të personalizuar, si ankime, kërkesa për pezullim ekzekutimi, padi gjyqësore ose letra zyrtare, të strukturuar sipas kërkesave procedurale me argumente ligjore, citime relevante dhe kërkesa specifike, të cilat juristët mund t'i shkarkojnë, editojnë dhe finalizojnë sipas nevojës.

Platforma duhet të ofrojë një ndërfaqe të thjeshtë për menaxhimin e çështjeve, ruajtjen e historikut të çështjeve, sistem të sigurt dokumentacioni me enkriptim “end-to-end” dhe akses të plotë nga çdo pajisje përmes ndërfaqes web në gjuhën shqipe, duke u mundësuar juristëve të kursejnë dhjetëra orë pune çdo muaj, të eliminojnë gabimet procedurale, të respektojnë afatet ligjore dhe të përqendrohen te strategjia juridike dhe jo në punë administrative përsëritëse.

Funksionalitetet kryesore:

- Analizë dhe Menaxhim i Dokumenteve Ligjore
- Asistencë për Juristët dhe Stafin Ligjor

-
- Menaxhim i Çështjeve Gjyqësore dhe Ankesave
 - Asistencë për Përputhshmëri dhe Auditim

13.1.10 Modul per arkivim digjital me procesim IA


Arkiva digjitale inteligjente mundëson:

- Konvertim automatik të dokumenteve në tekst të kërkueshëm
- Ekstraktim të informacionit kyç përmes OCR
- Gjenerim automatik të përmbledhjeve me LLM
- Kërkim semantik përmes vector embeddings
- Ruajtje të sigurt në vector database për akses të shpejtë
- Krijim dokumentave duke përdorur template edhe prompt ne IA me parametra (Psh: Gjenero shkresë njoftim për media)

Moduli do të lehtësojë arkivimin digjital të dokumentave, shkresave, raporteve të institucionit.

Dokumentacioni do të kategorizohet me fusha dinamike të cilat do të caktohen në bazë të llojit të dokumentit (psh data, nr. protokolli, institucioni lëshues, deleguar te, etj)

Çdo dokument do të përdoret për trajnimin e modelit që në vazhdimësi të ofrojë mundësinë e krijimit të një agjenti virtual i cili mund të ndihmojë punonjësit në kryerjen e proceseve të punës në mënyrë sa më efikase.



14. Arkitektura e Sistemit

Infrastructure Requirements:

- Cloud-native architecture
- Kubernetes orchestration
- Microservices API Gateway
- Load balancing dhe auto-scaling
- High availability (99.9% uptime)

AI/ML Stack:

- TensorFlow ose PyTorch për ML models
- OpenCV për computer vision
- spaCy ose NLTK për NLP
- Apache Spark për big data processing
- MLOps pipeline për model deployment

Siguria

Data Security:

- Enkriptimi AES-256 për të dhënat në rest
- TLS 1.3 për të dhënat në transit
- Role-based access control (RBAC)
- Multi-factor authentication
- GDPR compliance për të dhënat personale

System Security:

- Penetration testing
- Vulnerability scanning
- Security auditing
- Backup dhe disaster recovery
- SIEM integration

Performanca

Scalability:

- Horizontal scaling capability
- Auto-scaling based on load
- Caching strategy (Redis/Memcached)
- Database sharding nëse e nevojshme

Koha e përgjigjeve:

- Kërkesa API : < 200ms (95th percentile)
- Ngarkimi i panelit analitik: < 3 sekonda
- AI model inference: 5 - 60 sekonda në varësi të procesit

Batch processing: configurable

Funksionalitetet Kryesore të Infrastrukturës së Serverëve AI GPU On-Premises

Zgjidhja e propozuar do të duhet të përbëhet nga dy serverë GPU me performancë të lartë, të konfiguruar në arkitekturë të tepërt (redundante) për të garantuar vazhdimësi të shërbimit dhe disponueshmëri të lartë. Kjo infrastrukturë do të duhet të mundësojë zhvillimin, trajnimin dhe ekzekutimin e Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse, në mjedis të sigurt dhe të kontrolluar brenda OSHEE-së.

Krijimi i Infrastrukturës së Serverëve AI GPU do të shërbejë për të mundësuar

1. Kapacitet i Lartë Përpunimi për AI

- Çdo server do të duhet të pajiset me GPU enterprise-grade të optimizuara për përpunim të përshpejtuar në AI.
- Do të duhet të mundësojë përpunim paralel duke reduktuar ndjeshëm kohën e trajnimit në krahasim me përpunimin e bazuar vetëm në CPU.

2. Redundancë dhe Disponueshmëri e Lartë (High Availability)

- Dy serverët do të duhet të vendosen në konfigurim active/standby ose active/active sipas skenarit të përdorimit.
- Do të duhet të sigurojnë vazhdimësi të shërbimit në rast dështimi të njërit server.
- Do të duhet të mundësojnë migrim automatik të ngarkesave (failover) pa ndërprerje në shërbim.

3. Siguri dhe Respektim i Politikave të të Dhënave (On-Premise Data Sovereignty)

- Të gjitha të dhënat do të duhet të përpunohen lokalisht brenda infrastrukturës së OSHEE-se.

4. Arkitekturë e Shkallëzueshme (Scalable Architecture)

-
- Do të duhet të mbështesin zgjerimin e kapaciteteve duke shtuar GPU të reja, hapësirë ruajtjeje ose serverë shtesë në cluster.
 - Do të duhet të jetë i përputhshëm me platforma orkestrimi si Kubernetes për menaxhim të punëve të shpërndara AI.

5. Mbështetje për Multi-User dhe Multi-Projekte

- Do të duhet të mundësojnë punën e njëkohshme të ekipeve të ndryshme të analizës dhe të dhënave.
- Do të duhet të ofrojë izolim dhe menaxhim të burimeve përmes:
 - Virtualizimit

6. Ruajtje Enterprise dhe Menaxhim të Të Dhënave

- Do të duhet të mundësohet ruajtja në disqe NVMe me shpejtësi të lartë e cila do të sigurojë throughput optimal për Sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse.
- Do të duhet të mundësohet aksesin në storage të brendshme të të dhënave ose data warehouse ekzistuese të OSHEE-se.

7. Integrim me Infrastrukturën Ekzistuese IT

- Do të duhet të integrohet me:
 - Sistemin e Identifikimi dhe Autentikimi (AD/LDAP) OAuth 2.0 dhe OpenID
 - Platforma të bazave të të dhënave dhe sisteme analitike

-
- Sisteme backup-i dhe recovery në raste katastrofash

Këto integritete duhet të kryen në bashkëpunim me institucionin duke iu ofruar kontraktuesit informacionin edhe aksesin e nevojshme për të kryer integritet.

Raporte

Raportet që do përgatiten janë si në vijim, gjatë fazës të implementimit sipas nevojës mund të dakordësohet për të kryer ndryshime ose ndërtimin e një raporti të ri që nevojitet

Raport mbi skanimet e matesve elektrik

Përmbledhje automatike e çdo lloj ngarkuar:

- Saktësia në lexim për secilin lloj mates
- Identifikimi i anomalive
- Identifikimi i shifrave jo brenda pritshmërive

Raport i Zbulimit të Anomalive

Përdoret për të kapur gabime apo falsifikime:

- Fusha të munguar
- Informacion që nuk përputhet me standardet
- Zbulim i modeleve të pazakonta (p.sh. shenjat e manipulimit të imazhit)
- Nënshkrime të paqarta ose të dyshimta

Raport i Metadatave të Dokumentit

- Formati i dokumentit
- Madhësia
- Data e krijimit dhe e modifikimit
- Njohja e autorit
- Elementet e sigurisë (PDF certificate, encryption)

Raport Statistikash

Raportet mujore / javore:

- Nr. i dokumenteve të përpunuara

- Përqindja e dokumenteve të vlefshme vs. të pavlefshme
- Saktësia e OCR
- Llojet e dokumenteve më të përpunuara
- Koha që kursehet nga procesimi manual

Raport i Rrezikut & Përputhshmërisë

I dobishëm për klientët që kanë procese ligjore / financiare:

- Identifikim i fushave kritike
- Vlerësimi i rrezikut (Low/Medium/High)
- Përputhshmëria me standardet e industrisë
- Rekomandime për përmirësim

Raport OCR & Konvertimit në Tekst

Shfaq rezultatet e ekstraktimit:

- Teksti i plotë i përftuar nga dokumenti
- Përqindja e saktësisë së OCR sipas zonave
- Elementet e lexuar gabim dhe korrigjimet e sugjeruara
- Krahasimi i imazhit me tekstin e njohur për validim

15.KËRKESAT TEKNIKE

Operatori ekonomik fitues duhet të bëjë instalimet dhe konfigurimet për të gjitha pajisjet e ofertuara deri në qellimin final të këtij projekti. Operatori ekonomik fitues duhet të sigurojë dhe të gjithë infrastrukturën mbështetëse të nevojshme për zgjidhjen e dhënë.

Server AI GPU (2 Copë) - Kërkesat minimale teknike

Serverat AI GPU duhet të instalohen në një arkitekturë 2 nje (gpu-1, gpu-2 (secili server do jete i perbere nga : min. 2×64-core GPUs, min. $\geq 2 \times$ NVIDIA L40S, 256 RAM) në mënyrë të tillë që nëse një server dëmtohet, Sistemi të Inteligjencës Artificiale mbështetëse të jetë përsëri aktiv. Serverat duhet të jenë në cluster me njeri-tjetrin për të patur siguri më të lartë.(HA)

Kërkohet që të 2 (dy) serverët objekt i këtij prokurimi të ekzekutojnë konteinerë dhe ndajnë ngarkesën përmes një cluster psh. Kubernetes.

Funksionalitetet e mëposhtme janë kërkesë e detyrueshme për cilësinë e projektit:

- Virtualizimi i node-ve fizike në mënyrë që të mundësojë përputhshmërinë me platforma orkestrimi si Kubernetes për menaxhim të punëve të shpërndara AI.
- Sistemi i operimit OS hypervisor do të duhet të jetë në RAID1.

- Në disqet SSD (4×1.92 TB) → do të duhet te konfigurohet në RAID10 për vonesë të ulët(low latency)/ IOPS të lartë.
- Në disqet arkive HDD set (1×8 TB) → do të duhet te konfigurohet në RAID1 (ne të cilën do të ruhen backups, logs dhe datasets).
- Zgjidhja duhet të ofrojë support për rritjen e kapacitetit duke shtuar GPU nodes, memorje ose cdo pajisje tjetër në makinën virtuale si të jetë e nevojshme pa shkaktuar ndërhyrje në funksionimin e sistemit të operimit.

Operatori ekonomik fitues përveç implementimit të sistemit të Inteligjencës Artificiale mbështetëse dhe optimizimit të tij duhet të krijojë dhe një ambient test në mënyrë që çdo konfigurim apo testim që mund të ndodhë në të ardhmen, të testohet paraprakisht në këtë ambient dhe me vonë ndryshimet të realizohen në mjedisin real të punës. Kjo do të ndihmonte në qëndrueshmërinë e sistemit real të punës dhe do të shmangte problemet e gjeneruara gjatë konfigurimeve të pajisjeve fizike, konfigurimeve të rrjetit apo updateve që realizohen mbi sistemin.

Form Factor	I montueshem në rack, min. 2U. Të ketë të përfshirë shinat dhe aksesoret e nevojshëm për montim në rack.
Procesor	2 x Procesor min 64 cores me min. 100,000 pike per cpu sipas benchmark të publikuar në https://www.cpubenchmark.net
GPU chip	≥ 2 x NVIDIA L40S 48 GB GDDR6 me ECC
Memorie (RAM)	≥ 256 GB DDR5 ECC – e shtueshme deri në të paktën 1TB
Controller	Kontroller RAID SAS/SATA/SSD të mbështesë RAID 0, 1, 10, 5.
HDD	- 2 x 480 GB Enterprise SATA SSDs for OS, të konfiguruar në RAID 1 - 4 x 1.92T SSD16Gtps 2.5 per (DATA) - 2 x 8TB SATA 6Gbps 7.2 rpm 3.5 (ARKIVE)
NICs	Min. 2 porta 10Gb Ethernet fiber
OS i suportuar	Microsoft Windows Server, Red Hat Enterprise Linux, SUSE Linux Enterprise Server, CentOS, etj
Power Supply	Redundant, Hot Plug
Te tjera	Kabllo Fiber Optike, 2 copë, multimode, LC-LC, 2 metra
Garancia	3 Vite

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 98,650,000 (Nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2022, 2023, 2024. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39,000,000 (Tridhjetë e nëntë milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

-
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001:2022 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme) dhe ISO 20000-1 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit. (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve / mallrave / shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike objektin e prokurimit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (Dhjetë) punonjës të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate perkatese si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilet:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalente.
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate/system administrator ose ekuivalente;
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet server, të nivelit Arkitekt ose ekuivalent;
